



Titulli i projektit

Kompletimi & përditësimi i Planit të Zhvillimit Urban - me theks Zona e Shërbimit të Mbështetjes me Shërbime Tregtare Plotësuese

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik/Kohezion Social

Vendndodhja e projektit

Manzë

Buxheti i paravlerësuar

15,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Bashkia e Manzës është e vetmja që ka të përgatitur një Plan Zhvillimi Urban (dhe pse të paaprovuar akoma). Logjika themelore e këtij plani është që të ofrojë shërbime jo vetëm për bashkinë e Manzës (duke qënë se nuk ka popullatën e nevojshme apo veprimtarinë ekonomike), por dhe për Durrësin, Ishmin, Rashbullin, Katundin e Ri.

Një nga projektet e identifikuara në Planin e Zhvillimit Urban është krijimi i Zonës së Shërbimit të Mbështetjes me Shërbime Tregtare Plotësuese. Kjo zonë do t'i shërbejë zhvillimit urban të Gjirit të Lalzit. Ky plan duhet të përshtatet me territorin dhe profilin socio-ekonomik të Bashkisë së re. Në këtë fazë ne duam të fokusohemi tek komponenti i Zonës së Shërbimit të Mbështetjes me Shërbime Tregtare Plotësuese (ZSMSTP).

Qëllimi/et specifik të projektit

Objektivi i projektit është adaptimi, promovimi dhe aprovimi i planit të ZSMSTP nga Bashkia e re Durrës. Qëllimi përfundimtar është përmirësimi i nivelit dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve tregtare për banorët e Manzës, por kryesisht për pushuesit e Gjirit të Lalzit.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme përfshijnë:

- rritja e numrit të shërbimeve dhe përmirësimi i nivelit të tyre;
- përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për pushuesit e Gjirit të Lalzit;
- rritja e nivelit të interesit të popullatës për të kaluar pushimet në Gjirin e Lalzit dhe rritja e numrit të pushuesve;
- përmirësimi dhe promovimi i turizmit detar.

Shërbimet tregtare plotësuese do të ndikojnë direkt në përmirësimin e nivelit të shërbimeve që do t'u ofrohen 6652 banorëve të Manzës dhe pushuesve të Gjirit të Lalzit.

PROJEKTI 9



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Kohëzgjatja e përafërt e projektit është 6 muaj.

Aktivitetet e parashikuara përfshijnë:

- (a) vlerësimi i nevojave dhe planifikimi i ndërhyrjes;
- (b) tenderimi, kontraktimi dhe zbatimi i kontratës së rishikimit të planit ekzistues në funksion të profilit të Bashkisë së re;
- (c) konsultimi dhe promovimi pranë banorëve dhe këshilltarëve të bashkisë së re.

Maturimi i projektit

Aktualisht nuk evidentohet kryerja e ndonjë studimi fizibiliteti.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burim i mundshëm finacimi janë fondet publike të Bashkisë së re Durrës, ose fonde publike-private.

Kostot e projektit

Kostoja e projektit vlerësohet të jetë rreth 15,000 Euro